

[IMER MISLIMI, ZAMAN SHQIP]

Aplikimi i gazit natyral edhe pse me vonesë do të sjell ndryshime esenciale

Shpëtimi nga faturat e larta të energjisë elektrike shihet tek gazifikimi. Strumica mbetet shembull i vetëm i gazifikimit lokal.

Aplikimi i sistemit të gazifikimit që do të përfshinte amvisëritë në Maqedoni, edhe pse është një proces që parashikohet të përfundoj diku deri në vitin 2040, për Maqedoninë do të jetë një pikë kthyesë. Momentalisht Maqedonia, importon gaz natyral nga Rusia, i cili përmes Bullgarisë kalon në Kriva Pallankë, Kratovë dhe në Kumanovë, dhe prej këtu në Rajonin Industrial për Zhvillim të Teknologjisë në Shkup. Ky gaz përdoret vetëm për nevojat e sektorit industrial. Para disa javësh qeveria e Maqedonisë nënshkroi një marrëveshje me Deutsche Bank dhe Erste Bank, për një kredi prej 90 milion eurove për ndërtimin e rrjetit të gazsjellësit në drejtimet Shtip-Negotinë-Manastir dhe Shkup-Tetovë-Gostivar. Përdërisa diskutimet dhe pyetjet për aplikimin e gazsjellësit akoma vazhdojnë të jenë aktuale, nga ana tjetër qytetarët bëhen kureshtarë për atë se çfarë

ndryshimi do të sjell aplikimi i gazit natyral në jetën e tyre.

Përdorimi i gazit natyral do ta zhduk varfërinë energjetike
Në një shtet si Maqedonia ku mbi 60% e amvisërive në aspektin energjetik konsiderohen si të varfër, gjegjësisht nuk mund të nxehin shtëpitë apo banesat e tyre tërësisht, por vetëm pjesë-pjesë, gjë që vjen si rezultat i çmimit të shtrenjtë të rrymës elektrike dhe të drurit, me aplikimin e gazit natyral mendohet të ketë ulje të harxhimeve tek amvisëritë nga 30% deri në 50%. Këtë gjë më së miri e shpjegon edhe drejtori i Burimeve Energjetike të Maqedonisë, Krste Miladinov, në një prononcim publik ka pohuar se përdorimi i gazit natyral mënyrë të konsiderueshme do të zvogëlojë vlerën e faturave tek amvisëritë dhe do të rris konkurrencën dhe fitimin në ekonomi si dhe kualitetin në prodhim.



ANA STOJILOVSKA, DOKTORANT I STUDIMEVE EKOLOGJIKE PRANË UNIVERSITETIT EVROPIAN QENDROR NË BUDAPEST DHE BASHKËPUNËTOR I JASHTËM HULUMTUES PËR ÇËSHTJE ENERGETIKE NË ORGANIZATËN TINK-TANK ANALITIKA, SHKUP



PËRDORIMI I GAZIT NATYRAL DO TË JETË NJË ALTERNATIVË E RE PËR QYTETARËT

Deri në vitin 2040, gaz natyral në tërë territorin e Maqedonisë Sipas të dhënave të komisionit rregullatorë për energjetikë, përdorimi i kapacitetit të sistemit aktual për përcjellje të gazit natyral në vitin 2014 është akoma më i ulët me afër 17% të përdorimit. Kjo bëhet si rezultat i rrjetit të pavarur për shpërndarje të gazit të pazhvilluar me të cilët përfshihen vetëm kapacitete më të larta industriale, me përjashtim të qytetit të Strumicës, Kumanovës dhe zonës së zhvillimit për Industri Teknologjike Bunarxhik, mbi të cilën është ndërtuar një rrjetë e përshtatshëm shpërndarje të gazit natyral në një hapësirë prej 22km, 10km dhe 5.2 km. Si rezultat i projekteve lokale për gazifikim në Strumicë dhe Kumanovë, një pjesë e konsumatorëve reklamuese, një pjesë e institucioneve publike dhe një pjesë e amvisërive gjithashtu janë duke e përdorur gazin natyral.

Studim-fizibiliteti për zhvillimin e sistemit të rrjetit për gaz në Maqedoni, është realizuar në vitin 2010 nga ana e Ministrisë së Transportit dhe të Lidhjes, studim i cili analizon mundësinë për gazifikim afatgjatë në të gjithë territorin e Maqedonisë, proces që do të zgjas deri në vitin 2040. Sipas strategjisë për zhvillimin e energjetikës deri në vitin 2030, zhvillimi i sistemit të rrjetit për gazë natyral fillimisht duhet të realizohet duke nisur nga drejtimi Kleçovce - Sv. Nikole - Shtip - Radovish - Strumicë - Gjevgjeli dhe në drejtim Shkup - Tetovë - Gostivar. Sa për ilustrim, Maqedonia solli ligj për ndërtimin e rrjetit për gazifikim në rajonin Kleçovce - bllok stacioni i 5-të, pjesën më të madhe e së cilës do ta financohet Rusia. Paralelisht me këtë duhet të shpallen edhe tenderë për partneritete publike-private për ndërtimin e rrjetit për shpërndarje të gazit. Qëllimi është që të përfshihet tërë vendi, kurse kycja do të bëhet rajonale, që do të thotë më shumë komuna me projekte. Kjo ndodh sepse ka nevojë për më shumë përdorues të gazit në atë mënyrë që investimi të mund të paguhet.

VETËM 10% E QYTETARËVE JANË TË KYÇUR NË NXEHJEN QENDRORE

Gazi natyral është energji e pastër që do të mundësojë zëvendësimin e nxehtësisë me dru dhe me energji elektrike dhe bashkë me këtë do të përfitojmë një mjedis më të pastër. Gjendja momentale e nxehtësisë është shumë larg nga idealja, ku afër 10% të qytetarëve janë të kyçur në sistemin e nxehtësisë qendrore, kurse një pjesë e madhe e qytetarëve përdorin nxehtësi me energji elektrike ose dru. Të dhënat e vitit 2010 tregojnë se rreth 30% e amvisërive për nxehtësi përdorin energjinë elektrike, kurse 48% e tyre përdorin dru. Këto dy lloje të nxehtësisë janë problematike ngaqë nxehtësia me energji elektrike rezulton në humbje të madhe të energjisë, kurse nxehtësia me dru në Maqedoni është e lidhur me de-pyllumin dhe prerjen e drurit në mënyrë jolegale. Në të njëjtën kohë, pasi qytetarët të shkyçen nga ngrohja qendrore fillojnë të përdorin ngrohjen me energji elektrike ose dru, për shkak se opsione tjera nuk ka. Kur bëhet shumë ftohtë qytetarët janë të detyruar të përdorin edhe nxehtësi shtesë elektrike, me të cilin ngrohen edhe për një kohë më të gjatë, gjë e cila rrit harxhimin e energjisë elektrike. Një situatë e tillë është rrezikshme për sigurinë energjetike në shtet ngaqë mund të sjell deri në mungesën e energjisë elektrike. Një gjë e tillë e kemi përjetuar në muajin shkurt të vitit 2012, kur dimri ishte shumë i ftohtë dhe Maqedonia proklamoi krizë energjetike, kurse masat që u ndër-

morën ishin që të minimizohet ndriçimi rrugor, dhe duke e kufizuar përdorimin e energjisë elektrike për ngrohje shtesë. Një fakt jo pak më i rëndësishëm është edhe ajo se 60% të amvisërive në vend në aspektin energjetik janë të varfër, gjegjësisht nuk mund të sigurojnë nxehtësi të mjaftueshme për shtëpitë e tyre që të mund t'i kryejnë punët e përditshme. Kjo gjendje dramatike drejtpërdrejtë është e lidhur me mënyrën e nxehtësisë, në kushte ku përdorimi i energjisë elektrike është duke u shtrenjtuar, kurse amvisëritë e varfra energjetike mundohen ta përdorin nxehtësinë sa më pak andaj edhe hapësirat ku rinë nuk mund të ngrohen, por vetëm pjesë pjesë. Kjo gjë ndodh edhe me amvisëritë që përdorin dru, si dhe shtëpi jo të izoluar mirë, ku një pjesë e mirë e nxehtësisë po humbet.

NDRYSHIMET NË ÇMIMIN E RRYMËS ELEKTRIKE NUK VARET NGA PROCESI I GAZIFIKIMIT

Me aktivizimin e procesit për liberalizim të energjisë elektrike, çmimi i energjisë elektrike që përdoret nëpër amvisëritë fillimisht do të rritet sepse amvisëritë përdorin çmim të energjisë elektrike me subvencione të ulëta. Pasi amvisëritë të kenë mundësi të kyçen në gazin natyral, dhe si rezultat i kësaj do të ketë rritje të çmimit të rrymës elektrike, në këtë mënyrë qytetarët do të jenë të obliguar që të kyçen në rrjetin e gazifikimit, gjegjësisht ta ndërrojnë rrymën elektrike me gaz natyral. Çmimi i rrymës elektrike nuk varet nga procesi i gazifikimit. E njëjtë është edhe me çmimin e drurit. Me ardhjen e sistemit të gazifikimit, Maqedonia do të përdor më shumë gaz, gjë që do të haptë rrugën për zvogëlimin e çmimit të gazit natyral. Bashkë me këtë qytetarët do të kenë mundësi që të dalin nga gjendja e varfërisë energjetike.

PROJEKTI I GAZIFIKIMIT NË STRUMICË SHEMBULL I MIRË PËR KOMUNAT E TJERA

Projekti i gazifikimit në Strumicë është shembull i mirë për gazifikim lokal sidomos e dobishme për sipërfaqet e largëta që nuk kanë mundësi të kyçen në infrastrukturën e gazifikimit. Projekti i Strumicës tregoi se qytetarët kanë arritur të kursejnë mjete financiare për të siguruar resurse energjetike dhe tu mundësohet amvisërive që të kyçen në gazin natyral. Për sektorin privat, gazi natyral nënkupton konkurrencë më të madhe, kurse për amvisëritë do të thotë energji e pastër për ngrohje. Strumica është 200 km larg rrjetit aktual për gazifikim dhe më afër e ka mundësinë për tu siguruar me gaz natyral të ngjeshur nga Bullgaria. Është një shembull i mirë që tregon se mund të arrihet deri në gaz natyral lokal pa u kyçur në rrjetet të mëdha për gazifikim. Komuna e Strumicës këtë projekt e ka financuar me mjete vetanake dhe e ndërtoi rrjetin shpërndarëse lokale. Prej këtu mund të kuptohet se për të formuar sistem gazifikimi në vend duhet vullnet politik dhe zhvillim të rrjetit të gazifikimit nëpër vendbanimet tona. ■

